

AKT-THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
Nordic Freedom

NENI 1
FORMIMI

Sot me date 01.06.2024 themeluesi qe firmos me poshte:

1. **Z.Svein Erik Nilsen**, shtetas norvegjez, atesia Solveig, i datëlindjes 26.11.1967 lindur në Porsgrunn, Norvegji, banues në Trekanten 10, 3946 Porsgrunn, Norvegji, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.Personal: 34046111.

Ne baze te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 „Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare „, si dhe Ligji 9723 dt 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit “ themeloj me vullnet te lire shoqerine tregetare me pergjegjesi te kufizuar ,me emertim **Nordic Freedom** .

NENI 2
SELIA

Selia e shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **Nordic Freedom**, me adrese Tirane, Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89, Shkalla A, Kati 9, Ap.31. Shoqeria ka te drejte te hape filiale ne te gjithë vendin.

NENI 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **Nordic Freedom** eshte pa afat nga momenti i regjistrimit te saj prane QKB Tirane.

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise **Nordic Freedom** eshte:

- Sherbimi i organizimit te tureve me guida, toure pa guida, prenotime aktivitetesh te ndryshme per turista, prenotime makina me qera per klientet, Agjent dhe/ose ndermjetes per rezervimet Hoteleve, restoranteve, paketave turistike gjithëperfshirese per te trete vendas ose te huaj. Aktivitet tregtare ne fushen e turizmit kulturor dhe ne fushen e hotelerise, organizimi i udhetimeve turistike, biznes-ture, pushime, sherbime per udhetime tokesore, ajrore e detare. Rezervime dhe pergatitje biletash. Sherbime dhe pronotime hotelesh brenda dhe jashte vendit.
- Ofrimi i sherbimeve ne fushen e agroturizmit dhe turizmit. Degustime dhe shitje ne nivel te konsumit personal, te artikujve bujqesore e blegtorale, arvoreve, frutoreve, agrumeve, drithrat, ullinjve, vreshtave, mjaltit, vajit te ullirit, veres dhe pijeve te tjera alkoolike dhe reçelname.
- Investitor ne pasuri te paluajtshme, menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Dhenie me qira, nen qira te ambjenteve te ndryshme.

Shoqeria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera shtese, me qëllim permbushjen e veprimtarise të saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 5 KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqërisë **Nordic Freedom** është **100,000 leke** dhe i ndare në 1 kuote me kontributin e ortakut të vetëm të shoqërisë, si më poshtë:

1. Një kuote **Z.Svein Erik Nilsen**, në masën 100 % (nëqind për qind) të kapitalit themeltar.

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortakut themelues, ai mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrë ortakut, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 6 ORGANET E SHOQERISE DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese të shoqërisë **Nordic Freedom** janë:

- Asambleja e Ortakeve, organi më i lartë vendimmarres
- Administrator të shoqërisë është **Z.Svein Erik Nilsen**, me nr personal 34046111.
- Kohëzgjatja e administratorit është 5 vjet, **nga data 01/06/2024 deri në 01/06/2029**

NENI 7

Organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, shprehen në status që bashkë me aktin themelimit janë dokumentat baze të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

NENI 8

Veprimtarinë e saj, shoqëria do të zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

NENI 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statuti si dhe legjislacionin shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen me gjykatë.

Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **Nordic Freedom** në QKB në këtë ditë shoqëria **Nordic Freedom** njihet si person juridik.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE “Nordic Freedom“

Z. Svein Erik Nilsen

